

Gjykata Supreme e Kosovës
Prishtinë
Shkresat e Lëndës Nr. Api-Kzi 1/2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga
Maria Giuliana Civinini Gjyqtare e EULEX-it në Gjykatën Supreme dhe Kryetare e Kolegjit
Martti Harsia Gjyqtar i EULEX-it – anëtar i kolegjit
Marije Ademi Gjyqtare e Gjykatës Supreme - anëtare e kolegjit
Emine Mustafa Gjyqtare e Gjykatës Supreme - anëtare e kolegjit
Nesrin Lushta Gjyqtare e Gjykatës Supreme - anëtare e kolegjit

asistuar nga Zyrtarja Ligjore e EULEX-it Maria Rosa del Valle Lopez si procesmbajtëse, procesmbajtëset e EULEX-it Natasa Malesevic dhe Tsvetelina Zhekova dhe përkthyesit e EULEX-it Anila Shehu dhe Edmond Laska.

Në praninë e Prokurorit të EULEX-it Jakob Willaredt, avokatit mbrojtës Teki Bokshi dhe të pandehurit Shkumbin Mehmeti.

Në seancën e mbajtur më 26 nëntor 2010 në orën 11 paradite në Gjykatën Supreme të Kosovës në lëndën penale kundër të pandehurit:

Shkumbin Mehmeti, i lindur më 27 maj 1979 në Fshatin Pllakashticë, emri i të atit Gani Mehmeti, mbiemri i vajzërisë i së ëmës Zaide Gashi, Shqiptar i Kosovës, Ish oficer i Policisë së Kosovës, me vendbanim në rrugën Rozafati në Podujevë;

I akuzuar për vepër penale vrasje e rëndë vrasje e rëndë në tentativë [Neni 30 paragrafi 2 pika 2 dhe 6 e Ligjit Penal të Kosovës (LPK) lidhur me Nenet 19 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ)], posedim i paligjshëm i armëve [Nenet 8.2 dhe

8.6 të Rregullores së UNMIK- ut 2001/7 lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ-së] dhe posedim i paligjshëm i armëve. [Neni 328 paragrafi 2 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës–KPPK-].

Duke vendosur mbi ankesat kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të datës 27 janar 2010 (Ap-Kz. Nr. 190/09) të paraqitur nga (1) avokati mbrojtës Teki Bokshi më 8 mars 2010 përfaqësues i të pandehurit, (2) Gani Mehmeti, i ati i të pandehurit, më 18 mars 2003 dhe (3) i pandehuri vetë më 12 prill 2010.

Lëshon këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës Teki Bokshi më 8 mars 2010 si përfaqësues i të pandehurit.

HEDHET POSHTË ankesa e paraqitur nga Gani Mehmeti, i ati i të pandehurit, më 18 mars 2003.

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paraqitur nga vetë i pandehuri më 12 prill 2010.

ARSYETIMI

Historia e Procedurës

Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 9 nëntor 2007 lëshoi aktgjykimin P. Nr. 203/2005 dhe shpalli Shkumbin Mehmetin fajtor për këto vepra penale:

Vrasje e rëndë, të kryer me të tjerët, në kundërshtim të Nenit 30 paragrafi 2 pika 2 dhe 6 e Ligjit Penal të Kosovës (LPK) lidhur me Nenin 19 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ).

Vrasje në tentativë, të kryer me të tjerët, në kundërshtim të Nenit 30, paragrafi 2 pika 2 dhe 6 e LPK-së lidhur me Nenet 19 dhe 22 të KPRSFJ-së

Posedim i paligjshëm i armëve i kryer me të tjerët, në kundërshtim të Nenit 8.2 lidhur me Nenin 8.6 të Rregullores së UNMIK- ut 2001/7 lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ-së.

Posedim i paligjshëm i armëve, në kundërshtim të Nenit 8.2 lidhur me Nenin 8.6 të Rregullores së UNMIK- ut 2001/7.

Posedim i paligjshëm i armëve, në kundërshtim të Nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së.

Sipas Nenit 48 të KPRSFJ-së trupi gjykues i shqiptoi të akuzuarit një dënim unik me **tridhjetë (30) vjet burgim**.

Ankesa kundër Aktgjykimit Nr. 203/2005 të datës 9 nëntor të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë janë bërë nga (1) Gani Mehmeti, i ati i të pandehurit, (2) i pandehuri vetë dhe (3) nga avokati mbrojtës i të pandehurit.

Gjykata Supreme e Kosovës lëshoi një aktgjykim më 27 janar 2010, Ap.-Kz. Nr. 190/2010, duke zgjidhur këto ankesa dhe konstatoi:

Ankesa e paraqitur nga Gani Mehmeti hedhet poshtë si e palejueshme.

Ankesa e paraqitur nga Shkumbin Mehmeti refuzohet si e pabazuar.

Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit refuzohet si e pabazuar

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 203/2005 i datës 9 nëntor 2007 u ndryshua si në vijim:

“Cilësimet e veprës penale të kryer kundër Policit Ndërkombëtar Possible Kojo Essuman (UNMIK CIVPOL), dhe Policit Vendor Arsim Rrustolli (SHPK) dhe veprës penale të kryer kundër Policit Vendor Bastri Mulliqi (SHPK) dhe asistentit gjuhësor Ramë Zeneli (UNMIK) (ndryshimet a) dhe b) në dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 203/2005, të datës 9 nëntor 2007) janë një pikë e Vrasjes së rëndë dhe një pikë e Vrasjes së rëndë në tentativë sipas nenit 30 paragrafi (2) pika 6) e Ligjit Penal të Kosovës (LPK), lidhur me Nenin 19 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPSRFJ).

Dënimi i shqiptuar për të dy pikat Vrasje e Rëndë dhe Vrasje e Rëndë në Tentativë është tridhjetë (30) vite burgim. Dënimi unik për të gjitha pikat është tridhjetë (30) vite burgim.

Burgimi prej dymbëdhjetë (12) vitesh i shqiptuar për Shkumbin Mehmetin me aktvendimin e Gjykatës të Qarkut në Pejë P. Nr. 126/2005 i datës 3 Gusht 2005, i vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës më 30 Mars 2006, është përfshirë në dënimin unik prej tridhjetë (30) vitesh burgim.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 203/2005 i datës 9 Nëntor 2007 është VËRTETUAR në pjesët e mbetura.

Shpenzimet e procedurës të shkallës së dytë do të mbulohen nga i pandehuri.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 27 Janar 2010, Ap. – Kz. Nr. 190/2010 është ankimuar sipas Nenit 430 KPPK (1) më 8 Mars 2010 nga Avokati Mbrojtës Teki Bokshi në përfaqësimin e të pandehurit, (2) më 18 Mars 2003 nga Gani Mehmeti, i ati i të pandehurit dhe (3) më 12 Prill 2010 nga vetë i pandehuri.

Më 14 Qershor 2010 Prokurori i EULEX-it/ZPSK ka lëshuar një opinion mbi ankesat e dyta (Ref. PPA Nr. 01/2010).

Aktgjykimi aktual zbërthen ankesat e lartpërmendura kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të datës 27 Janar 2010, Ap – Kz. Nr. 190/2010.

Përmbledhje e fakteve kryesore relevante për këtë ankesë.

Sipas aktgjykimeve të shkallës së parë dhe të dytë faktet kryesore të mëposhtme mund të vërtetohen përtej dyshimit të arsyeshëm:

Në mbrëmjen e 23 Marsit 2004, disa ditë pas të ashtuquajturave trazira të Marsit, i akuzuari Shkumbin Mehmeti, i ndjeri Agron Sylejmani dhe së paku dy (2) persona të tjerë ishin armatosur, veshur me uniform ngjashëm si ushtarakë dhe në posedim të maskave afër rrugës kryesore Podujevë – Prishtinë afër fshatit Shakovicë.

Rreth orës 21.40 një veturë e Policisë së UNMIK-ut, ngjyrë të bardhë e të kuqe (e ashtuquajtur veturë Coca – Cola) ishte në vozitje në rrugën kryesore Podujevë - Prishtinë, në drejtim të Prishtinës. Personat në veturë ishin katër (4) anëtarë të ekipit të përzier të Policisë

vendor/ndërkombëtar, të vendosur në stacionin e policisë në Podujevë, ish stacioni ku punonte i akuzuari Shkumbin Mehmeti. Shoferi i veturës ishte Polic ndërkombëtar, Kojo Essuman (POLCIV UNMIK) nga Gana. Polici Arsim Rrustolli (SHPK) ishte ulur në ulësen e udhëtarit. Polici Bastri Mulliqi (SHPK) ishte ulur mbrapa në anën e djathtë. Përkthyesi Ramë Zeneli (punëtor i SHPK-së) ishte ulur mbrapa në të majtë.

Vetura e policisë ngadalë u afrua në hapësirën ku Shkumbin Mehmeti dhe shoqëruesit e tij po prisnin. Në këtë moment Shkumbin Mehmeti, Agron Sylejmani dhe dy (2) persona të paidentifikuar vrapuan drejt veturës së Policisë, secili nga ta duke bartur së paku një (1) armë automatike AK – 47, të mbushur dhe të gatshme për përdorim. Ata rrethuan veturën e Policisë e cila lëvizte shume ngadalë në gjysmë rrethi. Shkumbin Mehmeti dhe tre (3) sulmuesit e tjerë filluan të shkrepin – së paku njëqind e pesë (105) plumba në total – nga armët e tyre automatike në veturën e Policisë. Është e mundur që Kojo Essuman ishte qëlluar menjëherë nga disa plumba dhe plagosur për vdekje. Tërësisht dhjetë (10) plumba kanë shpuar trupin dhe kafkën e tij duke i shkaktuar fraktura të shumëfishta të kafkës, gërvishtje të rënda të trurit, lëndime shpuese të mushkërisë së majtë dhe të djathtë, mëlçi dhe bark, frakturë të tre (3) brinjëve si edhe frakturë të eshtrave të tjera. Ai nuk ka qenë në gjendje të mbaj kontroll të veturës më tej, e cila ngadalë është kthyer në të majtë dhe është ndalur pranë rrugës. Po ashtu edhe Arsim Rrustolli në ulësen e udhëtarit ishte gjuajtur me disa plumba dhe lënduar për vdekje. Ai ishte gjuajtur me plumba në veçanti në të majtë në pjesën e poshtme të shpinës duke i shkaktuar frakturë të një (1) brinje, lëndime shpuese të mushkërisë së majtë dhe të aortës së barkut. Ai ka arritur të hap derën e udhëtarit dhe ka rënë nga vetura në tokë ku ka vdekur nga humbja e gjakut disa minuta pas sulmit. Ramë Zeneli ishte mbledhur kruspull në mes mbështetëses së ulëses së parme dhe ulëses mbrapa. Në këtë mënyrë ai ka arritur tu ik shumicës së plumbave dhe të shpëtoj. Megjithatë ai u godit nga një plumb në shpatullën e majtë dhe copëzat metalike u ngjitën në kokën e tij.

Në kohën kur filloi sulmi, Polici Bastri Mulliqi, i cili ishte i frikësuar se nuk do të kishte rrugëdalje, ka hapur derën e pasme të anës së djathtë të veturës dhe në përpjekje për të ikur, ka dalë nga vetura. Ai u shtri në tokë, ka nxjerrë revolverin e tij dhe ka filluar të gjuaj në katër (4) sulmuesit. Dy (2) nga të gjuajturat e tij qëlluan sulmuesin Agron Sylejmani. Dy (2) nga shoqëruesit e tij e kanë kapur atë dhe e kanë tërhequr zvarrë.

Dy (2) nga sulmuesit ishin te vetura Opel Vectra, kanë hapur derën dhe kanë u bërtitur personave që ishin brenda që të dalin nga vetura. Personat që ishin në veturë dolën jashtë dhe autorët e krimit të armatosur kanë hyr në Opel, kanë bërë një kthim – U me veturë dhe kanë lëshuar vendin e ngjarjes, duke shkuar në drejtim të Podujevës. Dy (2) sulmuesit e tjerë kanë marrë një veturë tjetër me qëllim të ikjes nga vendi i ngjarjes. Ata po ashtu u kanë bërtitur personave në veturën Mercedes të dalin nga vetura, dy (2) autorët e krimit kanë hyr brenda, kanë bërë një kthim – U dhe kanë vozitur në drejtim të Podujevës.

Më pak se një orë nga sulmi, rreth orës 22.15. Mercedesi i rrëmbyer me tre (3) persona brenda ishte parë nga tre policë të cilët vozisnin një veturë të SHPK-së dhe të cilët tashmë ishin të njoftuar për pritën. Mercedesi, në përpjekje të qartë për të ikur, ka bërë një kthim të shpejtë në të majtë në një rrugë të ngushtë pa dalje. Policët i ka përcjellë. Tre (3) persona që kishin veshur uniforma sikurse ushtarak kanë lënë veturën. Dy (2) persona të cilët mbanin armët kanë qëndruar duke gjuajtur Policët. Personi i tretë ka shkrepur në Policët granatë nga hedhësi lëkundës mbi tavanin e Mercedesit. Asnjëri nga Policët nuk është lënduar dhe tre (3) autorët e krimit janë kthyer përreth dhe janë zhdukur në errësirë.

Gjatë inspektimit të Mercedesit, është gjetur një radiolidhje dore zyrtare në emër të Shkumbin Mehmetit në kohën kur ishte Polic.

Hetimet filluan menjëherë duke përfshirë edhe përgjimin e telefonit të Shkumbin Mehmetit. Bazuar në informatat e marra nga përgjimi i telefonit, hetuesit kanë pritur që Shkumbin Mehmeti të udhëtonte me veturë nga Prishtina në Pejë më 7 Prill 2004. Informata ishte e saktë. Rreth orës 15.40, Shkumbin Mehmeti ishte brenda një veture e cila kaloi pikën e parë kontrolluese të vendosur nga Policia. Pas ndjekjes, Shkumbin Mehmeti ishte paraburgosur (ishte plagosur në këmbë nga njëri Polic). Në kohën e arrestimit ai kishte në posedim tri (3) granate dore, një revolver një tytësh të kalibrit 40mm sistemi granate hedhës, të mbushur me tri (3) granata fosfori 40 mm, tri (3) granate tjera shtesë 40mm me eksplozive të lartë (HE) dhe tri (3) granata fosfori 40 mm. Gjithashtu kartela – Sim me numër të telefonit të përgjuar ishte konfiskuar nga Shkumbin Mehmeti.

Arsyetim

Ankesa e parashtruar nga Gani Mehmeti, babai i të pandehurit, është e papranueshme.

Sipas ankesës së parashtruar nga Gani Mehmeti “Unë, babai i të pandehurit Shkumbin Mehmeti, kam të drejtën e parashtrimin të ankesës në dobi të tij, bazuar në Nenin 360, par. 2 të Ligjit të Procedurës Penale të ish-Jugosllavisë (...). Incidenti në fjalë për të cilin është akuzuar biri im, ka ndodhur në kohën kur ky ligj ka qenë në fuqi, prandaj kam të drejtën e shfrytëzimit të interesave dhe privilegjeve të përcaktuara me këtë ligj (...)”.

Në këtë aspekt, data kur kanë ndodhur faktet nuk përcakton se cili ligj procedural do të zbatohet në këtë rast. Me qëllim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm në procedurë, ne duhet patjetër të marrim parasysh “Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare” të kodit të fundit procedural, në këtë rast, Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK - UNMIK/REG/2003/26).

Në këtë kuptim, sipas “Dispozitave Kalimtare dhe Përfundimtare” të KPPK-së:

Data e hyrjes në fuqi të KPPK-së është data 6 prill 2004 (Neni 557 i KPPK-së). Për ato lëndë të cilat kanë qenë në vazhdim e sipër më 6 prill 2004 (Neni 550 i KPPK-së): (a) nëse aktakuza, propozimakuza ose padia private është ngritur para datës 6 prill 2004 atëherë do të zbatohet ligji i mëhershëm procedural dhe (b) nëse aktakuza, propozimakuza ose padia private është ngritur pas datës 6 prill 2004 atëherë do të zbatohet KPPK-ja.

Në këtë rast konkret, ngjarjet kanë ndodhur më 23 mars 2004 por aktakuza e parë është ngritur pas datës 6 prill 2004. Për këtë arsye, ligji i zbatueshëm procedural është KPPK-ja dhe jo Ligji i Procedurës Penale të ish-Jugosllavisë, siç pretendohet nga Gani Mehmeti, babai i të pandehurit.

Pasi u konstatua se ligji i zbatueshëm procedural në këtë rast është KPPK-ja, pavarësisht nëse ankesa e parashtruar nga babai i të pandehurit është e pranueshme apo jo, atëherë është

vendosur drejt me aktgjykimin e shkallë së dytë, Ap.-Kz. Nr. 190/2009, të datës 27 janar 2010, faqe 3, paragrafi 8 i versionit në gjuhën angleze: “ankesa e Gani Mehmetit, babait të të akuzuarit, nuk është e pranueshme sepse ai nuk ka të drejtë në ankesë, duke mos qenë person i autorizuar (sipas nenit 399.1 të KPPK-së).”

Aktgjykimi i ankimuar nuk i jep arsyet pse përgjegjësia e cila në fillim iu ngarkua 13 njerëzve i ngarkohet vetëm Shkumbin Mehmetit.

I pandehuri Shkumbin Mehmeti ka përgjegjësinë e vet penale duke u bazuar në dëshmitë e gjetura kundër tij gjatë procedurës; përgjegjësia nuk është kaluar tek i pandehuri nga asnjë i bashkakuzuar tjetër. Aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë kanë konstatuar përgjegjësinë penale të të pandehurit pa asnjë fije dyshimi. Objekt i kësaj ankese është dënimi i të pandehurit dhe jo arsyet pse të akuzuarit e tjerë janë liruar nga akuzat në shkallën e parë.

Arsyetimi i këtij aktgjykimi është në kundërshtim me dëshmitë e dhëna se përkthyesi nuk është person zyrtar i cili ka qenë duke ushtruar detyrat e veta për sigurinë publike dhe për zbatimin e ligjit.

Përkthyesi Ramë Zeneli është lënduar gjatë sulmit në veturën e UNMIK-ut derisa ka qenë në detyrë zyrtare; ai ka qenë duke ndihmuar policët ndërkombëtarë dhe ata vendorë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare. Përkthyesit japin ndihmë thelbësore në kontekste ndërkombëtare kur kemi të bëjmë me ekipe të përziera të policëve vendorë dhe ndërkombëtarë; përkthyesit luajnë një rol vital për kryerjen e detyrave zyrtare. Për këtë arsye, përkthyesi Ramë Zeneli gëzon të njëjtën mbrojtje sikur edhe personat e tjerë zyrtarë prandaj zbatohen rrethanat rënduese.

Aspekti i rregullsisë së shqyrtimit të mbajtur në objektin e Burgut të Dubravës.

Me qëllim të përcaktimit nëse shqyrtimi i mbajtur në Burgun e Dubravës ka qenë në pajtim me ligjin apo jo, së pari duhet të vlerësohet nëse ndryshimi i vendit është vendosur si duhet

apo jo nga autoriteti përkatës. Në këtë kuptim, më 9 qershor 2006, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP-ja) ka miratuar ndryshimin e vendit të mbajtjes së shqyrtimit në Burgun e Dubravës. Në këtë kuptim, PSSP-ja është autoriteti i duhur për këtë miratim në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 1/1999, Neni 1: *“Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm”*.

Për më tepër, aktgjykimi i shkallës së dytë në faqen 3 të versionit në gjuhën angleze me të drejtë ka konstatuar se kanë ekzistuar të gjitha garancitë për një gjykim të ndershëm të përcaktuar me KPPK dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) gjatë shqyrtimit të mbajtur në Burgun e Dubravës (p.sh. qasja e publikut dhe e shtypit duke përfshirë anëtarët e familjes së viktimave dhe/ose të të akuzuarve, lejimi i kontaktit në mes të avokatit mbrojtës dhe të të akuzuarit, palët kanë mundur të gëzojnë të drejtën e tyre në mbrojtje).

Përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë në përputhje me ligjin duke pasur parasysh faktin se përjashtimi i Kryetarit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës është mohuar nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës.

Kjo çështje është zgjidhur në mënyrë të drejtë me aktgjykimin e shkallës së dytë, faqja 4, paragrafi 2: *“Përbërja e trupit gjykues ka qenë ligjore dhe kërkesa për përjashtim është vendosur në mënyrë ligjore nga Nënkryetari i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në mungesë të Kryetarit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës (i cili ka qenë në pushim) (ky vendim mban datën 31 gusht 2006 me numër P. Nr. 155/2006, Gjyqtari Mejdë Dehari, duke refuzuar kërkesën për përjashtim, bazuar në Nenin 43, paragrafin 1 të KPPK-së”*.

Në këtë kuptim, kur Kryetari mungon në gjykatë (p.sh. kur është në pushim), dikush tjetër nga gjykata duhet patjetër që ta zëvendësojë Kryetarin me qëllim të mbajtjes së punës normale të gjykatës; gjyqtari i cili e zëvendëson Kryetarin (në këtë rast Nënkryetarin) ka

saktësisht të njëjtat autorizime dhe funksione sikur Kryetari dhe kryen saktësisht të njëjtat detyra. Pra ai është “Ushtues i detyrës së kryetarit”.

Akuzat kundër të pandehurit Shkumbin Mehmeti nuk janë provuar.

Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se akuzat kundër të pandehurit Shkumbin Mehmeti janë vërtetuar plotësisht me anë të dëshmive të qarta dhe të shumta. Është provuar përtej çfarëdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Shkumbin Mehmeti dhe së paku tre kryerës të tjerë kanë vrarë Policin ndërkombëtar Possible Kojo Essuman (UNMIK CIVPOL) dhe Policin vendor Arsim Rustollin dhe kanë plagosur Policin vendor Batri Mulliqin dhe Përkthyesin Ramë Zenelin. Lidhur me këtë, dëshmitë kryesore që mbështesin akuzat kundër Shkumbin Mehmetit janë si në vijim:

Radio Motorola e gjetur në veturën Mercedes e cila është përdorur për tu arratisur pas pritës i ishte caktuar të pandehurit kur ka qenë Polic i SHPK-së; kjo informatë i ka qar hetuesit që ta përgjojnë telefonin mobil të pandehurit 044403051.

Informata e siguruar nga përgjimi i numrit 044403051 i ka bërë hetuesit të presin që Shkumbin Mehmeti do të udhëtoj me veturë nga Prishtina në Pejë më 7 prill 2004; prandaj, ishin vendosur dy pika kontrolluese të policisë. Informata në të vërtetë ishte e saktë dhe ka rezultuar në arrestimin e të pandehurit në po të njëjtën ditë. Fakti se bisedat e numrit 044403051 kanë shpie në paraburgimin e vetë të pandehurit dhe jo në paraburgimin e ndonjë personi tjetër, në mënyrë absolute dëshmon se vetë i pandehuri është zëri prapa bisedave telefonike të numrit 044403051.

Për më tepër, dhe vetëm si vërtetim, telefoni mobil i përdorur me numrin e SIM-kartelës 044403051 është konfiskuar nga Shkumbin Mehmeti gjatë arrestimit të tij.

Në kuptim të njëjtë, dhe përsëri si vërtetim, ish Polici i SHPK-së koleg i të pandehurit, dëshmitari Gojart Kelmendi, gjithashtu e ka identifikuar zërin e tij në përgjim. Pretendimet se dëshmitari ka konspiruar me forcat Serbe në mënyrë që ta sigurojë dënimin e të pandehurit për arsye politike nuk janë mbështetur nga asnjë element i dëshmimeve; sidoqoftë, fakti se i pandehuri ka qenë personi i cili ka përdorur numrin 044403051 tanimë është vërtetuar përtej çfarëdo dyshimi të arsyeshëm dhe dëshmia e këtij dëshmitari nuk është esenciale.

Në mënyrë të njëjtë, i pandehuri e identifikon vetën me emër në një bisedë të përgjuar më 6 prill 2004 në ora 19:57, me avokaten e quajtur Besime.

Në shkallën e dytë, janë ngritur pretendimet se radioja Motorola ishte shitur nga i pandehuri të ndjerit Agron Sylejmanit gjashtë muaj para ngjarjeve dhe se i pandehuri nuk ishte në posedim të radios në kohën e pritës. Pretendimi kundërshtohet nga faktet: radioja Motorola ishte elementi fillestar për përcjelljen e të pandehurit dhe vendosjen e përgjimit të telefonit të tij mobil dhe përgjimi ka mundur kapjen dhe arrestimin e tij. Pretendimi gjithashtu nuk provohet: deklarata me shkrim e vëllait të të ndjerit Agron Sylejmani nuk e ka vlerën e një dëshmie; nëse i pandehuri ka dashur ta provoj rrethanën, ai dhe avokati i tij mbrojtës është dashur të kërkojnë me kohë gjatë gjykimit në shkallën e parë që ta dëgjojnë atë si dëshmitar. Arsyeja për mosveprim në këtë mënyrë (respekti për përkujtimin e Agron Sylejmanit) është e paqëndrueshme dhe jo e besueshme.

Posa është qartësuar se i pandehuri Shkumbin Mehmeti është personi prapa numrit 044403051, Gjykata Supreme ka analizuar nëse ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme që provojnë kryerjen e krimeve nga i pandehuri. Në këtë kuptim, gjithashtu ekzistojnë dëshmi bindëse dhe kategorike që dëshmojnë ekzekutimin e krimeve nga i pandehuri Shkumbin Mehmeti:

Një numër i madh i thirrjeve telefonike nga numri 044403051 në numrin +4155283329 i cili i takon një femre që jeton në Zvicër me të cilën i pandehuri kishte aferë dashurie; në veçanti, **gjatë bisedës së 25 marsit 2004, në ora 9:20, i pandehuri Shkumbin Mehmeti ka pranuar se ai ka qenë njëri prej kryerësve:** *“kur mendoj se të gjithë kanë mundur të vdesin atje (...) duhet të ishte unë ose ai (Agron Sylejmani), sepse vetëm unë dhe ai ishim afër (...) dhe ai e pagoi me jetë ”*

Gjithashtu ka pasur edhe përgjime tjera të telefonave të cilat në mënyrë të qartë e vërtetojnë pranimin, në veçanti, më 25 mars 2004 në ora 10:23, i pandehuri vërteton se *“Ai (Agron Sylejmani) ka vdekur në duart e mia.”*

Gjithashtu, një numër i bisedave konfirmojnë pranimin e detajeve dhe informatave lidhur me faktet dhe rrethanat e krimit; në lidhje me këtë, p.sh. më 30 mars 2004 në ora 16:45 *“ata morën kryefamiljarin (Gani Mehmetin) dhe ata gjetën të gjitha (...) ato që i ke pasur, ata i kanë gjetur”;* më 25 mars 2004 në ora 9:25 *“kam rënë në ujë gjatë ikjes sepse ne ishim të bllokuar të rrethuar (...) disi arritëm të dalim. Ne shpëtuam”;* më 6 prill 2004 në ora 19:57 Shkumbin Mehmeti i ka treguar avokates me emër Besime (numër 238550710) se babai i tij ishte i pafajshëm (i paraburgosur) dhe se ishte ai i cili kërkohet nga Policia.

Është e qartë se i pandehuri Shkumbin Mehmeti flet lirshëm në telefon – kryesisht me dashnoren e tij dhe me persona të tjerë-, ai vërteton se ai është njëri nga kryerësit e pritës dhe haptazi përshkruar rrethanat dhe faktet që kanë të bëjnë me krimet.

Kërkesa e bërë nga avokati mbrojtës i të pandehurit për një ekspertizë të zërit në mënyrë që të përcaktohet nëse i pandehuri është personi i cili ka përdorur numrin 044403051.

Sic u tregua më lart, Gjykata Supreme beson se ekzistojnë elemente të mjaftueshme të dëshmive për të vërtetuar se i pandehuri Shkumbin Mehmeti është personi prapa përgjimeve

të numrit të telefonit 044403051 dhe se lidhur me këtë ekspertiza e zërit nuk është e nevojshme.

Kërkesa e bërë prej avokatit mbrojtës për largimin e bisedës telefonike në mes të avokates të quajtur Besime dhe të pandehurit Shkumbin Mehmeti.

Kjo çështje tashmë është zgjidhur me aktgjykimin e shkallës së dytë, faqe 4, paragrafi 4 i versionit në Gj. angleze: “Mbrojtja nuk jep interpretim të drejtë të rregullave të zbatueshme në veçanti lidhur me përgjimin e bisedës telefonike në mes të klientit dhe avokatit mbrojtës. Në këtë rast Shkumbin Mehmeti me të vërtetë i telefonoi avokatit mbrojtës por ky avokat NUK ishte avokati i tij mbrojtës, ai ishte një prej personave tjerë.”

Në ankesën e dytë, avokati mbrojtës i të pandehurit pretendon veç kësaj se “Nuk është relevante që avokati nuk ishte avokat mbrojtës i të pandehurit Shkumbin. Ajo vazhdoi (mbeti, qëndroi) në këtë çështje dhe interesat gjyqësore të pandehurit Shkumbin dhe të klientit të saj ishin identike”.

Në këtë aspekt, përjashtimet e rregullës janë të lidhura me marrëdhënien shumë të veçantë klient/avokat, cila është lidhja (marrëdhënia) në mes të pandehurit dhe avokatit që e përfaqëson atë në procedurë; që marrëdhënia e veçantë nuk ndodh në mes të gjithë të pandehurve me gjithë avokatët e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte në lëndë. Të qenit avokat nuk do të thotë të ketë imunitet ndaj përgjimeve telefonike. Përjashtim në këtë rregull është nënkuptuar që të mbrohet marrëdhënia e veçantë i mbrojturi/avokati dhe jo të shërbej për interesat e përbashkëta të palëve.

Nëse përgjimet telefonike janë në pajtim me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

Mbrojta e të drejtës themelore të jetës private dhe korrespondencës, si autoritetet publike mund të ndërhyjnë në komunikimet private të qytetarëve, mënyra e ushtrimit të tij dhe si të mbrohen individët kundër ndërhyrjes arbitrare në çështjet e rëndësisë së madhe.

Në lidhje me këtë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) ka tërhequr vëmendjen në këtë pikë në shumë raste dhe ka zhvilluar një jurisprudencë të qëndrueshme lidhur me përgjimin e komunikimeve me qëllim të hetimeve policore. Në këtë aspekt, GjEDNj-ja ka vërtetuar se ligji që rregullon përgjimet duhet të jetë mjaft i qartë lidhur me rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuar të ndërhyjnë në të drejtën e jetës private dhe korrespondencës. Ligji që e drejton përgjimet telefonike duhet të tregoj fushën e diskrecionit, procedurave dhe kushteve dhe ti ofroj individëve mjete juridike të mjaftueshme kundër veprimeve arbitrare. Në këtë aspekt, lënda e GjEDNj-së e Bykov kundër Ruisë (Kërkesa nr. 4378/02) aktgjykimi i 10 marsit 2009 dhe aktgjykimet i referohen si në vijim:

“Gjykata në mënyrë të qëndrueshme është mbështetur që kur të vjen tek përgjimi i komunikimeve me qëllim të hetimeve policore, “ligji duhet të jetë mjaft i qartë në kushtet e tij që të jep qytetarëve një treguar adekuat sa i përket rrethanave dhe kushteve në të cilat autoritetet publike janë të autorizuar të drejtojnë në këtë sekret dhe ndërhyrje të mundshme të rrezikshme me të drejtën e respektimit të jetës private dhe korrespondencës” (shih Malone kundër Britanisë së Bashkuar, 2 gusht 1984, § 67, Series A nr. 82). Në veçanti, me qëllim të përputhjes me kërkesat e “kualitetit të ligjit”, ligji i cili diskuton diskrecionin duhet të tregoj fushën e atij diskrecioni, edhe pse procedurat dhe kushtet e hollësishme që duhen të vëzhgohen nuk duhet domosdoshmërisht që të jenë të përfshira në rregullat e së drejtës materiale. Shkalla e precizitetit e kërkuar prej “ligjit” në këtë lidhje do të varet prej lëndës së veçantë. Pasi që zbatimi në praktikë i masave të vëzhgimit të fshehtë të komunikimeve nuk është i hapur për shqyrtim nga individët e shqetësuar apo nga publiku, do të ishte në kundërshtim me sundimin e ligjit për diskrecionin ligjor të lejuar ekzekutivit – apo gjyqtarit – që të shprehet në kushtet e pushtetit të papenguar. Si pasojë, ligji duhet të tregoj fushën e çfarëdo i akorduar në autoritetet kompetente dhe të mënyrës së ushtrimit të tij me qartësi të mjaftueshme ti jepet individit mbrojtje adekuate kundër ndërhyrjes arbitrare (shih, në mes autoriteteve tjera, Huvig v. Francës, 24 prill 1990, §§ 29 dhe 32, Series A nr. 176-B; Amann kundër Zvicrës [GC], nr. 27798/95, § 56, GjEDNj 2000-II; dhe Valenzuela Contreras kundër Spanjës, 30 korrik 1998, § 46, Raportet e Aktgjyqimeve dhe Vendimeve 1998-V)”.

Me qëllim të përcaktimit të përputhjes me jurisprudencën e GjEDNj-së, është e nevojshme të kontrollohet nëse legjislacioni në Kosovë lidhur me përgjimin e telefonit përmbushë kërkesat e lartpërmendura.

Në këtë aspekt, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimeve janë të rregulluara në Kapitullin XXIX të KPPK-së dhe Rregulloreve së UNMIK-ut nr. 2002/6 *“Mbi Masat e Fshehta dhe Teknike të Vëzhgimit dhe Hetimit”*, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/3 dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/6. Të dyja këtë KPPK-ja dhe Rregulloret e UNMIK-ut janë në mënyrë përkryer në pajtim me kërkesat e lartpërmendura të GjEDNj-së; ky legjislacion rregullon në detaje, në mes tjerash, parakushtet për urdhërimin e masës, procedurën për të kërkuar urdhrin, natyrën dhe përmbajtjen e urdhrit, ndryshimin dhe zgjatjen e urdhrave dhe lejueshmërinë e të dhënave të arritura prej masave. Legjislacioni i Kosovës është në pajtim të plotë me kërkesat e themeluara nga GjEDNj-ja.

Sa i përket çështjes nëse procedura e zbatuar në shkallën e parë për përgjimet e telefonit ishte në pajtim me kërkesat ligjore të themeluara nga legjislacioni i Kosovës, është e qartë se kolegji i shkallës së parë është kujdesur në veçanti që mos të ndikoj në të drejtën e privacisë së të pandehurit. Në këtë aspekt faqja 40 e versionit në gjuhën angleze të aktgjykimit: *“Të shmang çfarëdo interpretimi të urdhrit të përgjimit që do të dëshmonte në dëm të të akuzuarit Shkumbin Mehmeti dhe të drejtës së tij për privati, kolegji e pranoi në të dhëna vetëm rezultatin e këtyre përgjimeve telefonike për numrin e telefonit 044403051 e që është zbatuar prej orës 00:00 me datën 25 mars 2004 e më tutje”*.

Përgjimet telefonike të kryera gjatë hetimit të krimeve janë në pajtim me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, me legjislacionin e Kosovës dhe janë dëshmi të përkryera të vlefshme në këtë procedurë.

Zbatimi i gabueshëm i dënimit: aktgjykimi i shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe i konsideron vrasjet e rënda dhe tentim vrasjen e rëndë si një akuzë e cila do të duhej të reflektohen në zvogëlimin e dënimit.

Pasi që dënimi me vdekje është larguar si sanksion i mundshëm nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 24/1999, dënimi për krimin më të rëndë është themeluar nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/59, neni 1.6. *“Për secilën vepër të dënueshme me dënim me vdekje sipas ligjit në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, dënimi do të jetë kohëzgjatja e burgimit në mes të minimumit të parashikuar me ligj për atë vepër dhe të maksimumit prej dyzet (40) viteve.”*

Duke marr parasysh mundësinë e shpalljes së dënimit prej dyzet (40) viteve me burg dhe faktit se i pandehuri është dënuar për krimet e vrasjes serioze dhe tentim vrasje serioze së bashku me tri akuza të posedimit të paligjshëm të armëve, dënimi unik prej tridhjetë (30) vjet është i ligjshëm dhe në pajtim me peshën ekstreme të krimeve.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Me 26 nëntor 2010, Shkresat e lëndës nr. Api-Kzi 1/2010

Kryetarja e kolegjit:

Maria Giuliana Civinini Gjyqtare e EULEX-it

Anëtar i kolegjit:

Martti Harsia Gjyqtar i EULEX-it

Anëtare e kolegjit:

Marije Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Anëtare i kolegjit:

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Anëtar i kolegjit:

Nesrine Lushta
Gjyqtare e Gjykatës Supreme